

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË

KIDS SMILE SH.P.K.

Sot, më 25.01.2023, **Fondacioni Zambak** një person juridik i themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën. Rr. e Dibrës, Nr.1, 32245 Tiranë, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Tiranës nr.792, datë. 02.06.2020 me NIPT:M01927452O në cilësinë e ortakut te vetëm, përfaqësuar nga **Ardit Dragoti**, i biri i Bujarit, shtetas shqiptar, lindur në Dragot/Elbasan, më datë 22.11.1988, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. Personal I81122021P, banues në Tiranë, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit, përfaqësues i tij, i caktuar me Vendimin e Bordit te Drejtorëve të datës 09.12.2022, përmes këtij akti themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me këtë akt dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria tregtare emërohet “**KIDS SMILE**” SH.P.K. (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Neni 2

Forma juridike

“**KIDS SMILE**” SH.P.K., është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, dhe veçanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, të ndryshuar dhe sipas këtij akti.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: “*Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Bernardin Palja, Ndertesa 15, Hyrja nr.1, Tiranë, Shqipëri*”.
- 3.2 Ortaku i Vetëm mund të hapë dhe/ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.



Neni 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “KIDS SMILE” Sh.p.k.. është duke përfshirë por pa u kufizuar në fushat e mëposhtme, :
1. Të hapë institucione parashkollore, çerdhe dhe kopshte.
 2. Të hapë qendra të shërbimit të përkujdesit rezidencial për fëmijë, shërbime të përkujdesit ditor për fëmijë.
 3. Të hapë shkolla fillore, nëntëvjeçare dhe të mesme.
 4. Të hapë universitete që përfshijnë kurset parauniversitare, studimet universitare, programe për master dhe doktoraturë.
 5. Të ndërkombëtarizojë universitetin duke vendosur praninë ndërkombëtare dhe zgjerimin e veprimtarive universitare nëpërmjet partneriteteve strategjike, blerjeve ose hapjeve të degëve në vendet e targetuara.
 6. Të themelojë, organizojë dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e instituteve shkencore, laboratorëve shkencore, qendrave shkencore, kërkimore dhe zhvillimore;
 7. Të themelojë, organizojë dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e kurseve dhe shkollave profesionale, kurseve parauniversitare, kurseve të ndryshme për gjuhë të huaja, për degë të ndryshme për përgatitje për në universitet, si dhe përgatitje për provime ndërkombëtare;
 8. Të themelojë, organizojë dhe të kujdeset për mbarëvajtjen qendrave të ndryshme kulturore dhe studimore, si dhe ofrimin e mënyrave të ndryshme të arsimit;
 9. Të botojë importojë dhe ekspozojë çdo lloj libri, reviste, broshure ose materiale të ndryshme për lëndët ose në ndihmë të tyre;
- 5.2 Shoqëria mund të ushtrojë edhe veprimtari të tjera në përputhje me të drejtën shqiptare.

Neni 6

Kapitali themeltar


- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Leke.
- 6.2 Kapitali themeltari i nënshkruar i Shoqërisë përbehet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) Leke.

Neni 7

Ortaku i Vetëm

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- **Fondacioni Zambak**, një person juridik i themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën. Rr. e Dibrës, Nr.1, 32245 Tiranë, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Tiranës nr.792 datë.02.06.2020 me NIPT: M019274520 në cilësinë e ortakut të vetëm, zotërues i 1 (një) kuote të barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar në shumën prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.



Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali i themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose me shume këste, me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotës ose nëpërmjet emetimit të kuotës/kuotave të reja për persona të tjerë.
- 8.2 Mënyra e shlyerjes së pjesës të zmadhuar të kapitalit bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe sipas përcaktimeve të vendimit të Ortakut të Vetëm.
- 8.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar, me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën vlerën 100 Lekë (*nje qind leke*), që është minimumi i përcaktuar me ligj.

Neni 9

Transferimi i kuotës

Ortaku i Vetëm mund të transferojë kuotën e tij, në çdo kohë, përmes shitjes, dhurimit, trashëgimisë apo ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Vendimmarrja

- 10.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.
- 10.2. Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - i. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - ii. ndryshimin e statutit;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre;
 - iv. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
 - v. transferimin e kuotës ose pjesëtimin e saj;
 - vi. shpërndarjen e fitimit;
 - vii. riorganizimin dhe/ose prishjen e Shoqërisë; dhe
 - viii. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe ky akt/statut.



Neni 11

Regjistri i Vendimeve

- 11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, vendimet për:
- i. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - iv. vendimet për investimet;
 - v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 11.2 Lista e mësipërme nuk është shteruese. Vendimet e paregjistruara ne Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht te pavlefshme.

Neni 12

Administrimi

- 12.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator.
- 12.2 Administratori emërohet me vendim te Ortakut te Vetëm dhe shkarkohen ne çdo kohe me vendim te tij.
- 12.3 Administrator mund të emërohet çdo person fizik, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorëve do të përcaktohet në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm.
- 12.4 Administratori i Shoqërisë është:

Z. Gert NDREU, i biri i Perparimit, lindur në Palaman, më 01.03.1997, shtetas shqiptar identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. Personal J70301004Q.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- 13.1 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me parashikimet e këtij akti dhe legjislacionin në fuqi.
- 13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- i. zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe vendimeve e Ortakut të Vetëm;



- ii. sigurimin e përputhshmërisë së Shoqërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
 - iii. kryerjen e të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
 - iv. mirëmbajtjen e rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - v. përfaqësimin e Shoqërisë me palë të treta;
 - vi. kryerjen e gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, sipas legjislacionin në fuqi;
 - vii. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë akt.
- 13.3 Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet dhe të ketë të gjitha kompetencat, përveç atyre që me ligj dhe nga ky akt u janë kufizuar ose i janë lenë Ortakut të Vetëm.
- 13.4 Administratori mund të delegojë pjesë ose tërë kompetencat e tij tek persona të tjerë.

Neni 14

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose me shumë eksperteve kontabël të autorizuar, nëse kjo kërkohet nga ligji ose vendoset nga Ortaku i Vetëm.

Neni 15

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

- 15.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Viti i pare financiar do të fillojë ditën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe do të mbarojë me 31 Dhjetor 2023.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse ka një të tilla, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 15.4 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

Neni 16

Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 16.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.



- 16.2 Ortaku i Vetëm emëron një ose me shume likuidues, dhe përcakton tagrat e tyre ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 16.3 Shoqëria vazhdon te ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja te likuidimit deri ne përfundim te këtij procesi dhe gjate likuidimit togfjalëshi “*ne likuidim e sipër*” duhet te vihet pas emrit te Shoqërisë.

Neni 17

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 17.1 Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar, interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet te kryhen ne përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar. Persa nuk parashikohet ne këtë akt do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “*Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare*” i ndryshuar.
- 17.2 Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti gjykata kompetente për zgjidhen e çështjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor te Tiranës,.

Ky akt përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën angleze dhe shqipe. Ne rast mospërputhjes versioni ne gjuhen angleze do te mbizotërojë.

Për **ORTAKUN E VETËM**

FONDACIONI ZAMBAK

Emër Mbiemër

Ardit Dragoti

